VENDIM
Nr. 582, datë 6.10.2021

PËR DHËNIEN E STATUSIT TË VEÇANTË "INVESTITOR NË STRUKTURË AKOMODUESE ME 5 YJE, STATUS SPECIAL" APLIKUESIT "*MEDITERRANEAN INVESTMENT GROUP*" SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33/1, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1 Dhënien e statusit të veçantë "Investitor në strukturë akomoduese me 5 yje, status special" aplikuesit "*Mediterranean Investment Group*" sh.p.k.

2. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj